



Specialisti i Mbështetjes për Familjen

Parandalim, Partneritet dhe Mbështetje për Familjen (PPFS)



Për fëmijët dhe familjet që kanë nevojë për mbështetje



Kush jemi ne...

Ne jemi pjesë e Tusla, Agjencisë për Fëmijët dhe Familjen. Ne ofrojmë një shërbim ndihme për familjet që po kalojnë momente stresuese ose të vështira. Ne i ndihmojmë familjet të përballojnë dhe përmirësojnë më mirë jetën familjare.

Nëse jeni të gatshëm të punoni me ne, ne do t'ju mbështesim juve dhe fëmijët tuaj për të përballuar shqetësimet dhe për të përmirësuar cilësinë e jetës së familjes suaj, në mënyrë që fëmijët të jenë të sigurt dhe të arrijnë potencialin e tyre të plotë.

Ne punojmë me prindër nga të gjitha kulturat dhe prejardhjet dhe fëmijët e tyre të moshës deri 18 vjeç, por vetëm nëse prindërit duan që ne ta bëjmë këtë.



Si punojmë ne...

- Ne fokusohemi te pikat e forta të familjes suaj dhe atë që funksionon mirë.
- Ne ju mbështesim dhe ju inkurajojmë gjatë momenteve të vështira.
- Ne inkurajojmë marrëdhënie të mira brenda familjeve.
- Ne ndihmojmë në përmirësimin e rutinës në shtëpi, frekuentimin e shkollës dhe menaxhimin e parave.
- Ne ju ndihmojmë të lidheni me mbështetës të tjerë në komunitetin tuaj lokal.
- Ne punojmë me ju, fëmijën tuaj dhe të tjerë, si shkolla, infermierja e shëndetit publik dhe shërbimet e shëndetit mendor për t'i përmirësuar gjërat.
- Ne inkurajojmë aktivitetet në familje dhe arsimin e mëtejshëm.
- Ne promovojmë Meitheal. Meitheal është një mënyrë për të punuar me ju dhe familjen tuaj për të inkurajuar pikat tuaja të forta dhe për të identifikuar nevojat tuaja.

Çfarë mund të prisni nga Specialisti i Mbështetjes për Familjet

NE:

Do të punojmë sipas ritmit tuaj.

Do t'ju tregojmë qartë se kush jemi dhe çfarë bëjmë.

Do të jemi të sinqertë me ju.

Do të respektojmë konfidencialitetin tuaj në përputhje me Udhëzimet e "Children First", Rregulloret e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave.

Si mund të ndihmoni...

Ju mund të na ndihmoni t'ju ofrojmë ndihmën e duhur në kohën e duhur.

- Na tregoni rreth shqetësimeve tuaja për fëmijën dhe familjen tuaj.
- Na tregoni se çfarë funksionon mirë dhe çfarë ndihmon që gjërat të bëhen më të lehta.
- Na tregoni se çfarë doni të shikoni të përmirësohet dhe si mund të ndihmojmë.
- Na tregoni se kush tjetër është i rëndësishëm ose i dobishëm për fëmijët dhe familjen tuaj në këtë moment.



Pyetjet më të shpeshta

A do të vini në shtëpinë time?

Ne zakonisht punojmë me familjet në shtëpitë e tyre ose në komunitetet e tyre.

Çfarë ndodh nëse nuk dua mbështetje për familjen?

Është në dorën tuaj. Ne ofrojmë mbështetje për familjen vetëm nëse ju bini dakord të punoni me ne.

A mund të kontaktoj Shërbimin e Mbështetjes në Familje për mbështetje?

Po, ju mund të kontaktoni shërbimin për të diskutuar rreth nevojave tuaja për mbështetje, për të parë nëse mund t'ju ndihmojmë.

Çfarë thonë prindërit e tjerë rreth shërbimit

“Pjesëmarrja e djemve të mi në aktivitetet e familjes në shtëpi na solli më afër bashkë dhe ndihmoi në identifikimin e problemeve me djemtë.”


“(Specialistja e Mbështetjes për Familjet) solli ndryshim të madh për djalin tim të vogël... ajo kuptoi. Unë mund të them se çfarë mendoj... Ndihem më i lirë.”

“Më ndihmoi shumë duke më nxjerrë nga shtëpia dhe duke më treguar të gjitha aktivitetet që zhvillohen jashtë shtëpisë.”

“Më ka ndihmuar me menaxhimin e parave, sjelljen dhe më ka dhënë aftësi përbaluese. Më ka ndihmuar të menaxhoj dhe të përballoj më mirë jetën në momente të vështira.”



Për të mësuar më shumë,
ju lutemi, kontaktoni:



Për të mësuar më shumë, vizitoni:
Uebfaqen për Prindërimin /
Parenting 24/7:

 www.parenting24seven.ie

Faqja e internetit e CYPSC:

 www.cypsc.ie



Rialtas na hÉireann
Government of Ireland



Arna chomhchistiú ag
an Aontas Eorpach

Co-funded by the
European Union



An Roinn Leanaí, Comhionannais,
Michumais, Lánpháirtíochta agus Óige
Department of Children, Equality,
Disability, Integration and Youth

TUSLA

An Ghníomhaireacht um
Leanaí agus an Teaghlach
Child and Family Agency

Ky material është financuar nga CYPSC për ESF+.

ESF+ Action bashkëfinancohet nga Qeveria e Irlandës dhe Bashkimi Evropian.

Fondi Social Evropian /European Social Fund Plus (ESF+) është instrumenti kryesor i BE-së për investimin te njerëzit, duke u fokusuar në përmirësimin e mundësive për punësim dhe edukim, si edhe në përmirësimin e përfshirjes sociale dhe përballimit të varfërisë.

ESF+ implementohet nga Shtetet Anëtare të BE-së në partneritet me Komisionin Evropian dhe Autoritetin Menaxhues të ESF+ pranë Departamentit të Arsimit të Mëtejshëm dhe të Lartë, Kërkimeve, Inovacionit dhe Shkencës për implementimin e ESF+ në Irlandë.



Plain
English
Approved by NALA

tusla.ie



Për një listë të
plotë të të gjithë
menaxherëve të lartë
të PPFs, ju lutemi,
skanoni këtë kod QR.

